



Komuna e Klinës

Kryetari i Komunës

01Nr. 112-3663 /2026

Klinë, datë 02.02 /2026

Duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr.03/L-040, botuar në gazetën zyrtare nr. 28/2008 me dt.04.06.2008, dispozitat e nenit 13 të Ligjit për Qasje në Dokumente Publike, nr.06/L-081, G.Z nr.13/2019, dispozitat e nenit 91 të Statutit të Komunës së Klinës të vitit 2010, si dhe duke marrë parasysh nevojat zyrtare, Kryetari i Komunës së Klinës, mori këtë;

V E N D I M

1. SAMIJE GJERGJAJ, Zyrtare për Informim në Komunën e Klinës, **CAKTOHET** që të kryej punët dhe detyrat e zyrtares përgjegjëse për qasje në dokumente publike në Komunën e Klinës.
2. E përmendura autorizohet për pranimin dhe regjistrimin e kërkesave të pranuar për qasje në dokumente publike, kryerjen e shqyrtimit fillestar të këtyre kërkesave, për ruajtjen dhe mbajtjen e evidencave të këtyre kërkesave dhe raportimin rreth këtyre kërkesave si dhe përgjegjësitë tjera në përputhje me dispozitat e Ligjit për Qasje në Dokumente Publike, nr.06/L-081 dhe aktet tjera nënligjore pozitive.
3. Me rastin e hyrjes në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet vendimi, nr.01-112-21680/2024 i datës 10.07.2024 si dhe çdo akt tjetër që është në kundërshtim me këtë vendim.
4. Vendimi i është i plotfuqishëm dhe hynë në fuqi menjëherë.

Te njoftohet:

- E përmendura;
- Drejtoria e Administratës;
- Zyra e Informimit, si dhe;
- Arkivi.

Kryetari,
Zenun Elezaj



